



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
**PROKURORIA PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË
TË JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM
DURRËS**

NJOFTIM

PËR VEND VAKANT NË POZICIONIN SEKRETAR PRANË PROKURORËVE

Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, kërkon të punësojë **1 (një) punonjës në administratë në pozicionin “Sekretar pranë Prokurorëve”**.

NJOFTON:

1.Fillimin e procedurës së hapur për konkurim të kandidatëve për pozicionin **1 (një) vend “Sekretar pranë Prokurorëve”** në Prokurorinë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës.

2.Referuar neneve 68,74,75,76, të ligjit nr 97/2016 "Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë", kandidatët e interesuar për konkurim, përvec kushteve të përgjithshme për t'u pranuar në shërbimin civil, duhet të plotësojnë dhe kritere të veçanta si më poshtë:

Arsimi, trajnimi dhe eksperiencia:

1. Kushtet e përgjithshme:

Të jetë shtetas shqiptar;

Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;

Të zotërojë gjuhën shqipe, të shkruar dhe të folur;

Të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse;

Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundërvajtjeje penale me dashje si dhe të mos jetë nën hetim;

Të mos jetë marrë masa disiplinore në marrëdhënie punë dhe/ose ndonjë masë tjetër disiplinore, e cila është ende në fuqi, sipas legjislacionit, në momentin e konkurimit;

Të ketë përfunduar ciklin e parë të studimit Bachelor në drejtësi dhe ciklin e dytë të studimeve universitare Master për “Drejtësi”;

Të kenë përvojë punë jo me pak se një vit të njohur si praktikë profesionale ose çdo lloj përvojë tjetër profesionale që lidhet me prokurorinë;

Të njohë Ligjin “Për Rregullat e Etikës në Administratën Publike”;

Të njohë ligjin “Për Prokurorinë”;

Të ketë njohuri të gjuhëve të huaja.

2. Kushtet e posaçme:

Të ketë aftësi për të krijuar marrëdhënie pune efektive me stafin e prokurorisë.

Të ketë aftësi komunikuese dhe pune në grup.

Të ruajë sekretin hetimor.

Të ketë integritet dhe cilësi të larta morale.

Personat e interesuar duhet të paraqesin në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, **deri më datën 30.04.2025 ora 16.00, këto dokumenta:**

- a) Kërkesë për punësim.
- b) Fotokopje e letërnjoftimit/kartës së identitetit/pasaportë;
- c) CV (Jetëshkrim) të detajuar ;
- d) Diplomë e shkollës së lartë, master, çertifikatë notash dhe çdo diplomë tjetër që tregon specializimin në fushën e caktuar;
- e) Dëshmi penaliteti;
- f) Vërtetim nga Gjykata dhe Prokuroria që nuk ndiqet penalisht;
- g) Fotokopje të librezës së punës ose vërtetim nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore që të provojë punësimin e mëparshëm ose vërtetim nga qendra e mëparshme e punës, ku të evidentohet pozicioni i punës dhe kohëzgjatja;
- h) Vërtetim mjekësor për gjëndjen shëndetësore.

Pranimi i dokumentacionit të dorëzuar nga kandidatët do të bëhet në Zyrën e Protokollit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, **deri më datën 30.04.2025 ora 16.00.**

Konkurimi për vendin e punës në pozicionin “ Sekretar pranë Prokurorëve ” do të zhvillohet në dy faza :

Faza e parë: verifikimi i dokumentacionit të paraqitur nga kandidatët, e cila realizohet nga Kryesekretari i kësaj Prokurorie me qëllim vlerësimin e dokumentacionit nëse janë plotësuar kriteret e shpallura në njoftim.

Kandidatët të cilët nuk arrijnë të plotësojnë kërkesat e përcaktuara skualifikohen.

Faza e dytë: Testimi (me shkrim, me gojë).

Kandidatët e kualifikuar i nënshtrohen intervistës së strukturuar me gojë, vlerësimit me shkrim si dhe vlerësimit të jetëshkrimit ku konsiston arsimimi, përvoja e punës, kualifikimet, trajnimet aftësi profesionale.

Totali i pikëve të vlerësimit është 100 pikë të mundshme të cilat ndahen në këtë kategorizim:

Vlerësimi i jetëshkrimit, eksperiencia e trajnimeve etj, 20 pikë

Vlerësimi i testimit me shkrim, 50 pikë

Vlerësimi për intervistën e strukturuar me gojë, 30 pikë

Testimi do të bazohet në kërkesat mbi kriteret e veçanta dhe njohuritë mbi fushën e specifikuar.
Që kandidatët të shpallen fitues duhet të marrin mbi 70 pikë.

Vlerësimi i kandidatëve nga komisioni do të bëhet bazuar në dokumentacionin e paraqitur nga secili kandidat si dhe rezultati i testimit me shkrim dhe të intervistës me gojë me secilin prej tyre.

- Intervista e strukturuar me gojë do të zhvillohet në datë 05.05.2025 ora 10.00-12.00, në ambientet e Prokurorisë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës.

-Testimi me shkrim do të zhvillohet në datë 05.05.2025, ora 12:00 -14.00, në ambientet e Prokurorisë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë te Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës.

**KOMISIONI I PRANIMIT PËR PROCEDURAT E PUNËSIMIT NË
PROKURORINË PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË TË
JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM DURRËS**

